



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT

MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTARSTVO ZA FINANSIJE MINISTRY OF FINANCE

KKRF- KËSHILLI I KOSOVËS PËR RAPORTIM FINANCIAR
KSFI – KOSOVSKI SAVET ZA FINANSIJSKO IZVEŠTAVANJE
KCFR – KOSOVO FINANCIAL REPORTING COUNCIL

UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 2016/01

PËR LICENSIMIN E AUDITORËVE TË HUAJ DHE FIRMAVE TË HUAJA TË AUDITIMIT

Ligji Nr. 04/L-014 i jep Këshillit autoritetin të vendos regjimin për raportimin financiar të organizatave biznese në Kosovë, përfshirë çertifikimin e kontabilistëve dhe licencimin e auditorëve.

Gjatë implementimit të dispozitave ligjore të Ligji Nr. 04/L-014, Këshilli vështron standardet e aplikueshme ndërkombëtare, udhëzuesit dhe interpretimet dhe përafron praktikat në Kosovë me Direktivat relevante 4, 7 dhe 8 të Ligjit Europian të kompanive.

Direktiva e 8 e BE “Mbi auditimet ligjore të pasqyrave financiare vjetore dhe pasqyrave të konsoliduara financiare” dhe Standardi 8 Ndërkombëtar i Edukimit “Kërkesat për kompetencë për profesionistët e auditimit” të publikuara nga Bordi për Standardet Ndërkombëtare të Edukimit për Kontabilitet (BSNEK – IAESB) janë të një rëndësie të veçantë për qëllimin e kësaj urdhërese administrative.

Ky udhëzim administrativë përcakton kërkesat të cilat duhet të përmbushin auditorët e huaj dhe firmat e huaja të auditimit për t’u njohur si auditor ligjor dhe të kenë të drejtën të praktikojnë në Kosovë. Ky Udhëzim Administrativ, zëvendëson udhëzimin ekzistues administrativ:

- UA 2012/01 Për njohjen e auditorëve të jashtëm dhe firmave të jashtme të auditimit.

